



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.19/24
Prishtinë, më 6.11.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mergim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Njazi Isaku, Shqipe Metaj-Isufi, Ferat Shala, Avdullah Hoti, Pal Lekaj dhe Duda Balje.

Munguan:

Të ftuarit: Hekuran Murati, ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, Ahmet Ismaili, Guvernator, BQK, Vlora Spanca, Auditore e përgjithshme, ZKA, Florim Maxharraj, sekretar i komisionit, BQK.

Pjesëmarrësit tjerë: Sami Gashi, GP LVV, Elsa Krasniqi, GP LVV, Festim Bytyqi, këshilltar, GP AAK, Nexhmije Ahmeti, zyrtare për media, Kuvend, Driada Thaci, zyrtare për bashkëpunim, ZKA, Albana Bucaliu, asistente, Ema Krasniqi, monitoruese, KDI, Nikollë Ukaj, gazetar, TV Arbëria, Antigonë Isufi, gazetare, Kallxo.com, Donisa Fazliu, gazetare, KTV, Krenare Mulliqi, gazetare, ATV, Jeton Bajraktari, Kuvend, Anduena Shtavica, GP LDK, Egzona Tërdevci, këshilltare GP LVV.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Frina Kabashi, praktikante, D+.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 2.10.2024 dhe 9.10.2024;**
- 3. Votimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2023;**
- 4. Votimi i Raportit vjetor financiar i KOSTT SHA për vitin 2023;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative;**
- 7. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.08/L-328 për shërbimet e pagesave;**
- 8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025;**
- 9. Shqyrtimi i propozimeve të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale;**
- 10. Të ndryshme.**

1.Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash miratohet rendi i ditës.

2.Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 2.10.2024 dhe 9.10.2024;

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 2.10.2024 dhe 9.10.2024.

3.Votimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2023;

Kryetari, tha se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar më 25.10.2024, andaj e hedhim në votim Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2023. Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2023, të procedohet në Kuvend për shqyrtim;
2. Kryesia e Kuvendit, në bazë të nenit 29, të Ligjit nr. 03/L-209, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ftojë guvernatorin e BQK-së, për paraqitjen në Kuvend, të Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2023, me rastin e shqyrtimit të këtij raporti në Kuvend;

4.Votimi i Raportit vjetor financiar i KOSTT SHA për vitin 2023;

Kryetari, tha se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar më 9.10.2024, por kemi kërkuar sqarime për disa çështje të ngritura në komision nga deputetët, për të cilat kemi marr përgjigje nga KOSTT-i, andaj e procedojmë për votim. Kryetari konstatoi se nuk u miratua Raporti vjetor i KOSTT-it për vitin 2024.

5.Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror;

Kryetari: Projektligji nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror, është shqyrtuar nga Komisioni Funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, i cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni Funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se zbatimi i Projektligjin nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror nuk krijon kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, (duke nënkuptuar se të gjitha aktivitetet të cilat dalin nga ky projektligj do të mbulohen nga ndarjet buxhetore, të parapara më Ligjin Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 si dhe vlerësimeve për vitet 2025-2026 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror, nuk përmban kosto

shtesë buxhetore, për Buxhetin e Republikës së Kosovës;

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Projektligji nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

6.Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative;

Kryetari: Projektligji nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative, është shqyrtuar nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligji nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative, **do të ketë kosto shtesë buxhetore në shumë prej 2,866,452 euro si dhe rritje te numrit të punonjësve për 64 pozita, mjete këto dhe pozita të cilat nuk janë të planifikuara me Ligjin nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024** dhe vlerësimet për vitet 2024-2025 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si institucion përgjegjës për zbatimin e këtij projektligji. Në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, bazuar me raportin e pagave për muajin dhjetor 2023, janë 193 pozita të lira. Për këtë pikë kemi ftuar ministrin e financave, z. Hekuran Murati

Hekuran Murati: Sa i përket Këshillit Gjyqësor për pozitat e lira që mund të akomodohen brenda vitit fiskal, ndërsa për vitin 2025, me ligjet që hyjnë në fuqi mund të krijohen programe të reja, ndarje të reja, nga ato kontingjente në mënyrë të funksionalizimit të institucionit me mekanizmat që i përcakton ligji i ri në fuqi.

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative, përmban kosto shtese buxhetore, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7.Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.08/L-328 për shërbimet e pagesave;

Kryetari: Në bazë të nenit 74, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, para shqyrtimit të parë të projektligjit në seance plenare, Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, si Komision Funkcional, është ngarkuar që të shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me Rekomandime.

Për arsyetimin e këtij projektligj, e kemi ftuar ministrin e Financave, z. Hekuran Muratin.

Hekuran Murati: Me P/ligj synohet krijimi i një tregu më të integruar të pagesave në vend, nxitjen e konkurrencës, inovacionit, ngritjen e nivelit të sigurisë së shërbimeve të pagesave, përmirësim të mbrojtjes së pagesave si dhe uljen e kostos për shërbimet e pagesave të ofruara në vend dhe më gjerë.

P/ligji do të përafrojë kornizën ligjore dhe rregullative me direktivat dhe rregulloret e BE-së në fushën e pagesave e si rezultat ofrimin e mundësisë për përfshirjen e ofrueseve të shërbimeve të pagesave e që janë Banka dhe jo Banka në zonën e vetme të pagesave në euro **të quajtur SEPA**.

P/ligji paraqet bazën kryesore për plotësimin e kriterëve për aplikim në SEPA, njëkohësisht ofron një kornizë të përgjithshme dhe specifika teknike për shërbimet e pagesave dhe aktivitetet e ndërlidhura brenda Kosovës, për të harmonizuar me Direktivën e BE-së dhe Rregulloret përkatëse, bazuar edhe në zotimet ndërkombëtare të Kosovës për marrëveshjen e stabilizim asociimit të nënshkruar me BE-në.

Në përmbushjen e këtyre zotimeve P/ligji ka për qëllim transpozimin e plotë të direktivave relevante në fushën e pagesave.

Me P/ligj përcaktohen kërkesat e regjistrimit , kërkesat e kapitalit, mënyrën e angazhimit të agjentëve dhe kontraktim shërbimit për institucionet e pagesave vendos bazën ligjore për bankingun e hapur dhe për adoptimin e rregullave për identifikim më të avancuar të klientit në qasjen e shërbimeve të pagesave elektronike, rregullon më hollësisht institucionet e ofrimit të parave elektronike dhe kërkesave për ruajtjen e fondeve të klientëve nga ana e këtyre institucioneve, përfshirë kërkesat e avancuara të regjistrimit të tyre dhe dhe kërkesat e kapitalit.

Gjithashtu rrit transparencën mbi tarifatat duke lejuar shitësit të jenë profesionalë, kur pranojnë pagesa përmes kartelave, të sigurojë paanshmëri dhe proporcionalitet në licencimin dhe rregullimin e ofrueseve të shërbimit të pagesave dhe institucioneve të parave elektronike, të mundësojë modele inovative e të bërit biznes, të cilat lehtësojnë përdorimin e palëve të treta , të forcojë bazën ligjore mbikëqyrëse të BQK-së për shërbime të pagesave, të krijojë një kuadër për mbrojtjen e konsumatorit përfshirë mekanizmat monitorues dhe detyrues.

Mbi bazën e këtyre ndryshimeve, pra, adoptimin e Direktivave të BE-së për sa i përket shërbimit të pagesave.

Kryetari, konstatoi se me shumicë votash, komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr.08/L-328 për shërbimet e pagesave.

8.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025;

Kryetari: Në bazë të nenit 74, paragrafi 2 të Rregullores se Kuvendit, para shqyrtimit të parë të projektligjit

në mbledhje plenare, Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime.

Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ka proceduar brenda afatit ligjor në Kuvend Projektligjin nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere si Komision funksional, është ngarkuar që të shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me Rekomandime.

Për arsyetimin e këtij projektligj, e kemi ftuar ministrin e Financave, z. Hekuran Muratin.

Hekuran Murati: P/ligji për ndarjet buxhetore për vitin 2025, përcakton kornizat e zhvillimit ekonomik dhe mbështetjen e ekonomisë për vitin fiskal 2025.

Projekt buxheti parashihet të jetë 3 miliard e 675 milionë euro dhe financohet nga të hyrat buxhetore prej 3 miliard e 305 milionë euro, ndërsa pjesa tjetër do të jetë deficit buxhetor që në kuadër të rregullës fiskale parashihet prej 222 milionë euro apo 2% (per qind) e bruto prodhimit vendor e që është në përputhje me kërkesat dhe rregullën fiskale që parashihet me Ligjin për menaxhimin e financave publike, për hartimin e P/ligjit janë marrë parametrat e zhvillimit ekonomik dhe performancës së vitit aktual, përkundër situatës së vështirë të krijuar në nivelin global, rritja ekonomike ka shënuar performancë të mirë gjatë vitit 2024, në pjesën e parë të vitit fiskal ekonomia është zgjeruar në mesatare prej 4.9 % që është 1(një)pikë përqindje më e lartë se projeksionet fillestare të institucioneve financiare ndërkombëtare që vendosen rritjen ekonomike prej 3.8 apo 3.9 rritje, e që deri në fund të vitit pritet në terma real ekonomia të zgjerohet për 4.5% (për qind) ndërsa në 6.6% (për qind) në terma normal, gjithashtu edhe të hyrat buxhetore janar-shtator 2024, kanë shënuar performancë me rritje prej më shumë se 7%(për qind) e që nëse i shohim si të hyra tatimore rritja vazhdon të jetë në nivelin 10 apo 11%(për qind).

Për projeksionet për vitin 2025 rritja ekonomike parashihet prej 5.6% (për qind) në terma real dhe afërsisht rreth 7.4%(për qind) në terma normal.

Mergim Lushtaku: Vërejtjet për buxhetin janë në pasqyrat financiare që dëshmon se Ministria ka planifikuar dobët buxhetin. Në pasqyrat financiare të të gjitha ministrive, buxheti është shpenzuar në subvencione, shërbime dhe mallra, pa efekt për ekonominë, ndërsa realizimi i shpenzimeve kapitale ka qenë nën çdo nivel të planifikimit, përqindjet e realizimit janë të ulëta edhe të realizuara janë keqpërdor përmes tenderimeve njëburimore, këtë e kanë dëshmuar raportet e auditorit të cilët kanë dhënë rekomandime për modifikime.

Rritja sipas P/buxhetit, ku rritja e të hyrave buxhetore rritet për 8%(për qind) nuk është risi sepse kjo rritje parashihet në çdo projekt buxhet të çdo viti, ndërsa që Qeveria nuk ka ndërmarr masa për ndonjë risi në zhvillim vendi, vlen të theksohet se Qeveria me P/ligjin për buxhet ka dhënë shembullin më të keq në realizimin e investimeve kapitale e që sipas të dhënave janë realizuar vetëm 36%(për qind), ndërsa planifikimet për vitin 2025 reflektojnë mungesën e vullnetit të ministrit.

Ferat Shala, pyeti rreth mospërputhjeve në tabelën 2, tek përmbledhja e ndarjeve buxhetore për nivelin lokal në vlerë prej 2.5 milion euro, si ka mundësi që çështjet në tabelën 3.2 të investimeve kapitale të figuron zero mjete financiare.

Hekuran Murati: Mund të ketë shpërputhje tek klaozula për investime për arsye se disa komuna nuk e kanë miratua buxhetin, Komuna e Prishtinës, Zubin Potokut dhe ajo e Gjilanit, ndërsa te tabela 3.2 nënkupton se nuk ka rritje për institucionet e cekura.

Ferat Shala: Rritja e investimeve të reja (sipas raportit) prej 8%(për qind) a është e mjaftueshme dhe deri sa ka rritje (sipas projektbuxhetit) prej 9% në kategorinë subvencione dhe transfere e në planifikim zero si arsyetohet kjo?

Hekuran Murati : Nuk ka bartje, mund të ketë projekte që janë në vijim.

Ferat Shala: Sa janë në total investimet kapitale dhe subvencionet?

Hekuran Murati : 930 milionë euro janë investime kapitale, 916.5 janë për paga dhe shtesa, 1 miliard e 155 milionë janë për subvencione dhe transfere.

Pal Lekaj: P/buxheti është vetëm përsëritje e buxhetit nga vitet e kaluara, lidhur me bartjen e projekteve a janë shpenzuar mjetet konform kërkesave të qytetarëve, sa projekte janë të përfunduara gjatë mandatit aktual dhe si do të reagojë Qeveria në rast të mosmiratimit të P/ligjit për buxhet, në kontekstin e rritjes së pagave?

Hekuran Murati: Lidhur me përfundimin e projekteve, në asnjë Qeveri projektet nuk përfundojnë brenda një mandati, shumica e problemeve dhe vonesat kanë qenë arsye e kontratave të trashëguara nga Qeveritë e kaluara, ndërsa sa i përket mosmiratimit të buxhetit atëherë kuptohet që nuk do të ketë as paga.

Pal Lekaj, pyeti lidhur me vështirësitë e mosrealizimit të projektit për Urën në Gjilan.

Ferat Shala: Sa mjete janë ndarë për tunelin me Maqedoninë e Veriut sepse konsiderohet se ka shkelje ligjore?

Abdullah Hoti, komentoi për vërejtjet në projektbuxhet, se buxheti është tranzitor, masat kyçe 2021-2025 që nga 20 masa vetëm 7 kanë filluar të realizohen, Fondi Sovran, Banka Zhvillimore, Fondi për sigurime shëndetësore, me projektbuxhet ministria ka abuzuar me të drejtat ligjore në menaxhimin e e parasë publike dhe buxhetit të shtetit si p.sh.: Alokimi i fondeve nëpër Komuna është vonuar, mosrealizimi i projekteve në Komuna mosrealizimi i investimeve kapitale, avancat për projektet kapitale, subvencionet për ndërmarrje publike, problemi i keqmenaxhimit të kredive, kreditë për shpenzime rrjedhëse për më tepër sipas të dhënave mjetet janë afatizuar në BQK.

Mbi bazën e të dhënave të gjithë indikatorët makroekonomik tregojnë për dështim të plotë të qeverisjes dhe të gjitha Qeveritë e kaluara kanë pasur më tepër rritje buxhetore se sa kjo Qeveri.

Sa i përket deficitit tregtar për 10 vite ka pas një trend standard të rritjes së vogël në bazë të rritjes normale të ekonomisë, ndërsa tani ka defekt tregtar çka nënkupton se prodhimi vendor mungon e këtë e ka dëshmuar edhe ASK-ja.

Hekuran Murati, u përgjigj për disa çështje të ngritura, se tek investimet kapitale ekzekutimi nuk ka përfunduar për vitin 2024.

Sa i përket kredive dhe tërheqjes, mjafton që të shihet ecuria e tërheqjeve dhe nivelit sesa janë miratuar në Kuvend, për të kuptuar që tërheqja nga kreditë ka qenë më e lartë sesa niveli që është miratuar gjatë mandatit aktual.

Nijazi Isaku, duke iu drejtuar parafolësit Z. Hoti, tha se nga i njëjti pret një diskutim ndryshe dhe më profesional dhe duke e kritikuar se si mund të bën akuza të tilla, duke i ditur dështimet nga Qeveria kur ai vet ishte kryeministër.

Armend Muja, pyeti lidhur me shpenzimet, deri sa të hyrat buxhetore janë 3.3 miliard euro, e në vitin 2020 të hyrat buxhetore kanë qenë 1.7 miliard euro, kjo nënkupton se ka një dyfishim të të hyrave për një periudhë 5 vjeçare.

Në vitin 2011, të hyrat buxhetore kanë qenë 1.3 miliard euro, për 10 vite janë rrit në 1.7 miliard euro sepse në atë kohë nuk janë mbledh të hyra buxhetore, ndërsa shpenzime ka pasur, mesazhi i parë është se i gjithë shpenzimi është financuar nga të hyrat, e dyta tek kategoria e të hyrave, tek korporatat, tek të hyrat në të ardhura personale, të hyrat nga konsumi, të hyrat nga akcizat në mes vitit 2011, deri në vitin 2019 janë shtuar 30 milionë euro, ndërsa nga viti 2021, të hyrat janë trefishuar që do të thotë se në terma absolut është rritje e madhe, andaj është me rëndësi që të fokusohemi tek shpjegimi i të dhënave të sakta të publikuara.

Mergim Lushtaku: Disa komuna tek projektet komunale kanë realizuar edhe grante sepse ligji obligon mbështetjen e komunave, por është fatkeqësi që disa projekte të komunave janë larguar nga projektligji edhe pse ato kanë qenë të buxhetuara dhe kjo mosmbështetje e projekteve të komunave konsiderohet si hakmarrje politike.

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

9.Shqyrtimi i propozimeve të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale;

Kryetari, njoftoi anëtarët e Komisionit se në mbledhjen e mbajtur më 25.10.2024, ka shqyrtuar propozimet e Komisionit për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale dhe me propozimin e anëtarëve të komisionit u vendos që të ftohen edhe anëtarët e Komisionit përzgjedhës.

Ai ia kaloi fjalën Guvernatorit të Bankës Qendrore.

Ahmet Ismaili, njoftoi komisionin se për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ka dërguar propozimin për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të FKPK dhe i ka propozuar Kuvendit, që të emërojë dy (2) kandidatë për anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit Pensional, si në vijim:

- | | | |
|-------------------------|----------|------------------------------|
| 1. Arsim Bruçaj, | (anëtar) | (24,7 nga 30 pikë maksimale) |
| 2. Ali Vitija, | (anëtar) | (22,3 nga 30 pikë maksimale) |

Mandati i anëtarëve të emëruar në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, është katërvjeçar, në pajtim me nenin 4, paragrafin 6 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 2, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-116.

Mergim Lushtaku, pyeti pse nuk është marrë në konsideratë propozimi i BSPK-së për përzgjedhjen e një kandidati nga BSPK-ja që sipas nenit 9 vetëm BSPK-ja e ka të drejtën legjitime që të përfaqësohet me 1 anëtar.

Ahmet Ismaili: Ligji për fondet pensionale nuk përcakton që anëtari i Bordit duhet të jetë një anëtarë i një sindikate e as që përcakton madhësinë e sindikatës, në asnjë rast nuk i referohet as nominimit, as referimit, sipas nenit 4 paragrafi 4.3, kushti është që një anëtar të ketë integritet të njohur dhe duhet të procedojë aftësi dhe përvojë profesionale në çështje pensionale, financiare, investime dhe në çështje të sigurimit. Nga të gjithë anëtarët e bordit vetëm 1 është i deleguar nga Qeveria dhe i njëjti nuk ka të drejtë vote.

Mergim Lushtaku, kërkoi nga parafolësi që kjo çështje të adresohet me shkrim në Komision.

Kryetari, konstatoi që me shumice votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. I propozohet Kuvendit, të emërojë kandidatët e propozuar nga Komisioni për Përzgjedhje, për dy (2) anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, të renditur si në vijim, sipas pikëve të intervistimit:

1. **Arsim Bruçaj,** (anëtar) (24,7 nga 30 pikë maksimale)
2. **Ali Vitija,** (anëtar) (22,3 nga 30 pikë maksimale)

2. Mandati i anëtarëve të emëruar në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, është katërvjeçar, në pajtim me nenin 4, paragrafi 6 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-116.

1. Të ndryshme.

Armend Muja, njoftoi Komisionin për kërkesën e Drejtorit Rajonal për Evropën dhe Azinë Qendrore të Bankës Botërore, që me datën 13, në orën 16:00, të takohet me Komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit